VENDIM
Nr. 190, datë 30.8.2018

MBI SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË OSHEE SHA PËR TARIFAT E SHËRBIMIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, SIPAS NIVELIT TË TENSIONIT DHE LËNIEN NË FUQI TË ÇMIMEVE ME PAKICË PËR KLIENTËT QË SHËRBEHEN NGA FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL PËR VITIN 2018

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, germa "c", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", të ndryshuar, nenit 22 të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 30.8.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve në lidhje me kërkesën e OSHEE sh.a. për shqyrtimin e aplikimit të OSHEE sh.a., për tarifat e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike sipas nivelit të tensionit dhe lënien në fuqi të çmimeve me pakicë për klientët që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal për vitin 2018,

konstatoi se:

- Shoqëria OSHEE sh.a. me anë të shkresës nr. 26933 prot., datë 14.12.2017 dhe protokolluar në ERE me nr. 699/2 prot., datë 15.12.2017, ka paraqitur aplikimin për tarifat e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike sipas nivelit të tensionit dhe lënien në fuqi të çmimeve me pakicë për klientët që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal për vitin 2018.

- ERE, me vendimin nr. 211, datë 28.12.2017, filloi procedurën për shqyrtimin e aplikimit të OSHEE sh.a. për tarifat e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike sipas nivelit të tensionit dhe në pikën 2 të këtij vendimi, përcaktoi lënien në fuqi të çmimeve me pakicë për klientët që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal për vitin 2018.

- Në zbatim të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", përgjatë procesit të shqyrtimit të këtij aplikimi janë kryer veprimet procedurale të cilat përfshijnë:

- Publikimi i aplikimit në faqen zyrtare të ERE-s brenda afatit të përcaktuar në rregullat e ERE-s.

- Korrespondencë e mbajtur me shoqërinë OSHEE sh.a. për plotësimin e dokumentacionit, lidhur me aplikimin për tarifat e shërbimit të shpërndarjes së energjisë eklektike sipas nivelit të tensionit për vitin 2018 (korrespondencë e detajuar në relacionin e këtij vendimi).

- Korrespondencë e mbajtur me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë në përputhje me nenin 10, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike". ERE me anë të shkresës nr. 360 prot., datë 7.5.2018, iu drejtua Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, ku parashtroi problematikat e hasura në lidhje me përcaktimin e tarifave të shpërndarjes dhe çmimeve me pakicë për klientët që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal për vitin 2018.

- ERE, për qëllime të shqyrtimit të aplikimit të OSHEE sh.a. ka zhvilluar disa seanca dëgjimore, përfshirë një seancë dëgjimore publike me shoqërinë OSHEE sh.a., si dhe ftoi të gjitha palët e interesuara në lidhje me këtë proces. ERE organizoi edhe një takim konsultativ në të cilin iu la detyrë OSHEE sh.a. që të plotësojë të dhënat e kërkuara të cilat iu dërguan nëpërmjet postës elektronike të datës 15.5.2018.

- Lidhur me aplikimin e shoqërisë OSHEE sh.a., sipas shkresës nr. 26933 prot., datë 14.12.2017, duhet vënë në dukje se ai është bazuar mbi parashikime të treguesve të vitit 2017 pasi ky nuk ishte mbyllur ende. Më tej, ky aplikim është përditësuar pasi viti ushtrimor u mbyll, ku të dhënat e dërguara nga aplikuesi, si dhe çështjet e trajtuara gjatë seancave dëgjimore dhe teknike gjatë muajve janar–mars 2018, kanë shërbyer për të reflektuar një analizë më të saktë të të ardhurave të kërkuara nga shoqëria

OSHEE sh.a., për mbulimin e aktivitetit të licencuar për vitin 2018. Analiza e aplikimit dhe e dokumentacionit shtesë të dërguar në kuadër të kërkesave të ERE-s, si dhe çështjeve të diskutuara gjatë seancave dëgjimore janë bazuar në të dhënat e pasqyrave financiare, bilancit energjetik faktik dhe treguesve të tjerë tekniko-ekonomikë të shoqërisë OSHEE sh.a. për periudhën paraardhëse.

- Për qëllime të analizës së të ardhurave të kërkuara të shoqërisë për ushtrimin e aktivitetit të licencuar janë analizuar të gjithë zërat që lidhen me:

- Shpenzimet operative, për vitet 2015, 2016, 2017 dhe 2018. OPEX është analizuar duke iu referuar pasqyrave financiare (PF) të viteve respektive, deklarimit të bërë nga shoqëria në aplikimin e vitit 2018 dhe analizën konform metodologjisë së shpërndarjes dhe objektivit të humbjeve të energjisë elektrike në rrjet sipas nivelit të lejuar në vendimin e ERE-s nr. 148 datë 26.12.2014. Nga kjo analizë vërehet se OPEX-i i realizuar sipas PF-së së vitit 2015, në përgjithësi për të gjithë zërat rezultojnë në ulje kundrejt atij të miratuar nga ERE, duke përjashtuar gjobat e penalitetet. Sa u takon viteve 2016 dhe 2017, nisur nga fakti se periudha rregullatore është një vit, OPEX-et e pranuara nga ana jonë, janë ato të shpenzimeve të realizuara në fakt për vitin 2016 dhe 2017, por duke përjashtuar si jo të arsyeshme njohjen e shpenzimeve për panalitete dhe gjoba. OPEX paraqitet në rritje, kryesisht në zërat: Paga, mirëmbajtje dhe shpenzime të tjera. Nga analiza e të ardhurave të kërkuara për vitin 2018, OPEX-et e pranuara nga ERE janë ato të shpenzimeve të realizuara në fakt për vitin 2017, të indeksuara me inflacionin, si dhe kostot shtesë të parashikuara nga shoqëria. Zëri "Shpenzime për personelin", për vitin 2018, kundrejt 2014-ës rezulton me një rritje të konsiderueshme, por nga deklarimet e kompanisë sqarohet se këto vlera janë miratuar dhe nga Këshilli Mbikëqyrës dhe lidhen kryesisht me ristrukturimin e skemës organizative të shoqërisë, si dhe planin e masave në kuadrin e ndërhyrjes dhe të aksionit për uljen e humbjeve dhe rritjen e arkëtimeve. Shoqëria deklaron që paga e përputhur me shpërblimin, sipas vlerës së tregut, do të rrisë përgjegjshmërinë në punë, si dhe performancën e shoqërisë. Në lidhje me këtë zë për vitin 2018 pranohet rritja vetëm për efekt indeksimi. Zëri mirëmbajtje është kërkuar, gjithashtu, me rritje kundrejt atij të rezultuar për vitin 2017. Kryesisht, vërehet se shpenzimet për riparime në Rrjetin e Shpërndarjes përbëjnë pjesën kryesore të këtij zëri. Meqenëse të ardhurat për të mbuluar zërat e tjerë të OPEX-it për vitin 2018 janë rreth 3% më të larta se viti 2017, sipas PF-së pa përfshirë gjobat dhe penalitetet, vlerësohen si të arsyeshme kostot e kërkuara nga kompania.

- Kosto e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve: Kjo kosto, si pjesë e shpenzimeve operative, përbëhet nga kostot e blerjes së energjisë elektrike në treg të parregulluar, si dhe nga kostot e transmetimit të këtyre humbjeve, të cilat rezultojnë më të larta nga ato të miratuara, në kuadër të vendimit nr. 146, datë 26.12.2014, të Bordit të ERE-s. Sipas VKM-së nr. 171, datë 25.2.2015, "Për miratimin e planit të rimëkëmbjes financiare të sektorit të energjisë elektrike", këto kosto rezultojnë më të larta se sa nivelet e këtyre treguesve që përcakton ky vendim. Vërehet se në uljen e shpenzimeve të blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve, krahasuar me ato të miratuara për vitet respektive, ka ndikuar edhe faktori çmim i tregut, i cili ka pësuar ulje ndaj atij të parashikuar për vitet 2015 dhe 2016. Nga ana tjetër, kostoja e humbjeve për vitin 2017 dhe 2018, është ndikuar edhe nga çmimi më i lartë i blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit me përparësi dhe HEC "Ashta". Humbjet totale faktike në rrjet për vitet 2015, 2016 dhe 2017 rezultojnë me përmirësim, por përsëri ato janë më të larta se targetet e përcaktuar nga VKM-ja nr. 171, datë 25.2.2015. Efekti nga kjo kosto e tepërt përtej asaj të lejuar, ka impakt në të ardhurat e kërkuara për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike.

- Në lidhje me kostot kapitale, CAPEX, vlerat e RAB-it, të llogaritur nga ERE nuk përputhen me ato të paraqitura nga shoqëria në aplikimin e saj për vitin 2018. Mbi bazën e treguesve të shpjeguar në mënyrë të detajuar në relacionin e këtij vendimi dhe nisur nga vlera e RAB-it të pranuar nga ERE dhe ai i kërkuar nga shoqëria rezulton me diferencë dhe është e kuptueshme që edhe kthimi mbi RAB, i llogaritur do të jetë i ndryshëm. Për vitin 2017, vlera e RAB-it e llogaritur nga ERE është shumë më e

vogël se ajo e paraqitur nga shoqëria për vitin 2017 në aplikimin e saj për vitin 2018. Kjo është vazhdim i diferencave të paraqitura nga shoqëria për asetet deri në fund të vitit 2011, problem ky i trajtuar në analizën për të ardhurat e kërkuara të rishikuar për vitin 2015. Vlera e RAB-it për vitin 2017 reflekton investimet e reja të vitit 2015 dhe 2016 të marrë nga pasqyrat financiare, si dhe 1/2 e vlerës së aseteve të shtuara/investimeve të realizuara për vitin 2017, duke e konsideruar si vlerë të aseteve të vëna në operim për këtë periudhë. Kjo shifër rezulton nga pasqyrat financiare të vitit 2017. Vlera e RAB-it për vitin 2018 reflekton investimet e reja të vitit 2017 marrë nga pasqyrat financiare të kësaj periudhe.

- Të ardhurat e tjera si të ardhurat për lidhjet e reja dhe energjinë reaktive, të konsideruara të zbritshme për shoqërinë, janë ato të rezultuara në PF dhe të përditësuara sipas aplikimit.

- Energji e livruar në Rrjetin e Shpërndarjes, për vitet 2015, 2016, 2017 dhe rezulton në sasitë 4,459 gwh, për vitin 2015, 4,605 gwh për vitin 2016, 4,782 gwh për vitin 2017 dhe për vitin 2018 është pranuar sasia e energjisë së livruar prej 4,803 GWh.

- Nga raportimi i strukturës së shitjes për vitet 2015,2016 dhe 2017 rezulton që çmimi mesatar i realizuar nga shitja është më i lartë nga ai miratuar prej 10.7 lekë/kWh, duke rezultuar me të ardhura shtesë për shoqërinë. Këto diferenca vlerësohen të përdoren si rezervë për mbulimin e kapitalit negativ të trashëguar që nga viti 2014, duke i mundësuar shoqërisë aftësinë për likuidimin e detyrimeve, si dhe mbulimin e kostove të blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve mbi target.

- Përllogaritja e tarifave të aktivitetit të shpërndarjes sipas nivelit të tensionit

Shoqëria ka kërkuar tarifat e aksesit për nivel tensioni për vitin 2018 si më poshtë:

- Për vitin 2018, - 5.16 lekë;
- tension i mesëm -2.36 lekë;
- tension i mesëm (20–6 kV) – 3.81 lekë;
- tension i ulët (0.4 kV) – 5.51 lekë.

- Për përllogaritjet e këtyre tarifave, shoqëria shprehet se është bazuar në koeficientet e alokimit të shpenzimeve që marrin parasysh sasinë e energjisë elektrike të shitur sipas strukturës së shitjeve, strukturën e aseteve sipas niveleve të tensionit dhe humbjet teknike të energjisë elektrike sipas niveleve të tensionit. Koeficientët e llogaritur mbi bazë të peshës specifike të shitjes së energjisë elektrike në nivel tensioni, OSHEE sh.a. i ka përdorur për alokimin e shpenzimeve kapitale dhe të ardhurave nga lidhjet e reja dhe energjia reaktive. Për alokimin e shpenzimeve operative, shpenzimeve për mbulimin e humbjeve të energjisë elektrike, shoqëria ka përdorur koeficientët e ponderuar që marrin parasysh peshat specifike të energjisë elektrike të shitur dhe humbjet teknike.

- Konsiderojmë jokorrekte praktikën për alokimin e kostove kapitale, duke përdorur thjesht peshat specifike të konsumit të energjisë elektrike në atë nivel tensioni, pa marrë në konsideratë vlerat e aseteve për nivelet përkatëse të tensionit, si dhe faktin që asetet në nivele më të larta tensioni shërbejnë edhe për furnizimin e klientëve të lidhur në tensionet më të ulëta. Kostoja e përllogaritur për blerjen e humbjeve në Rrjetin e Shpërndarjes nuk është llogaritur në zbatim të përcaktimeve të VKM-së nr. 171, datë 25.2.2015, si dhe të VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016. Kështu që, llogaritjet tona reflektojnë këto diferenca në të ardhurat e kërkuara, të cilat në përfundim rezultojnë me një tarifë prej 4,85 nga 5,14 lekë, e kërkuar nga shoqëria OSHEE sh.a.

- Për të mundësuar përllogaritjet në mënyrë që tarifat e aksesit të pasqyrojnë kostot e arsyeshme të shërbimit në atë nivel tensioni, iu kërkuan shoqërisë vlerat e aseteve për çdo nivel tensioni, apo minimalisht shtesat e reja të aseteve për çdo nivel tensioni për periudhën 2014–2017. Për shkak se shoqëria nuk ka paraqitur informacion në plotësim të kësaj kërkese, kemi vënë në përdorim të vetmin informacion që trashëgojmë në lidhje me vlerat e aseteve për nivel tensioni, pra ato të datës 31.5.2014.

- Për shpërndarjen e kostos së humbjeve është konsideruar, gjithashtu:

a) Studimi i paraqitur nga shoqëria në lidhje me "Humbjet e energjisë elektrike aktive në rrjetat 35 kV për vitin 2017";

b) Studimi i paraqitur në aplikimin për tarifat e vitit 2017 në lidhje me humbjet në rrjetat e TM-së:

- Në llogaritjen e koeficientëve për alokimin e kostos së humbjeve është përdorur arsyetimi se një pjesë e humbjeve të shkaktuara në nivelet e mësipërme të tensionit i takojnë konsumit të energjisë elektrike në tensionet në vijim. Për këtë qëllim janë shfrytëzuar raportet e konsumit të energjisë elektrike në çdo nivel tensioni ndaj totalit të energjisë elektrike. Vlerësimet tona, bazohen në të dhënat e paraqitura nga shoqëria, dhe në vetvete mbartin pasiguri në shpërndarjen e kostove sipas nivelit të tensionit, ashtu siç deklarohet në aplikim.

- Për sa trajtohet në relacionion argumentues të këtij vendimi, vërehet se të ardhurat totale nga aktiviteti i shpërndarjes dhe i furnizimit me pakicë rezultojnë më të larta se ato të lejuara për periudhën 2015–2017, kjo për faktin se në llogaritjet tona nuk janë përfshirë kostot totale të blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në Rrjetin e Shpërndarjes, përtej targetit të përcaktuar në VKM-në nr. 171, datë 25.2.2015, vlerë kjo e konsiderueshme për shoqërinë dhe që në të njëjtën kohë do të kërkonte financime shtesë nga pronari shtet ose në të kundërt kjo vlerë duhet të mbulohet nga klientët që shërbehen nga FSHU-ja.

- OSHEE sh.a., me shkresën nr. 13063, datë 29.6.2018, informon se, në kuadër të rishikimit të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 171, datë 25.2.2015, "Për miratimin e Planit të Rimëkëmbjes Financiare të Sektorit të Energjisë Elektrike", shoqëria ka kërkuar ndër të tjera, ndryshimin e pjesës VI, "Veprimet/aktivitetet e planit të rimëkëmbjes financiare", germa "c" dhe konkretisht të pjesës ku thuhet: "Duhet të theksohet se këto tarifa përfshijnë vetëm humbjet teknike dhe nuk pasqyrojnë humbjet joteknike që janë rezultat i vjedhjes së energjisë elektrike nga një numër i madh konsumatorësh në kurriz të konsumatorëve të tjerë". Me këtë ndryshim do të hiqet pengesa për të përfshirë në përllogaritjen e tarifave humbjen e energjisë elektrike sipas planit të miratuar dhe jo vetëm humbjen teknike. Për pasojë, OSHEE sh.a. kërkon shtyrjen e shqyrtimit të miratimit të tarifave deri në marrjen e vendimit për ndryshime në Planin e Rimëkëmbjes.

- ERE, me shkresën nr. 360/1 prot., datë 11.7.2018, i ka kërkuar MIE-s, opinionin e saj në lidhje me argumentin e paraqitur nga OSHEE sh.a. për të shtyrë vendimmarrjen për tarifat e vitit 2018, si dhe në lidhje me problematikat e hasura në lidhje me përcaktimin e tarifave të shpërndarjes dhe çmimeve me pakicë të energjisë elektrike për vitin 2018, bërë prezente me shkresën e ERE-s nr. 360 prot., datë 7.5.2018.

- Lidhur me kërkesën e OSHEE-së nisur nga problematikat e paraqitura më lart dhe për më tepër deklarimi i kompanisë se:

- Është i domosdoshëm për shoqërinë, mbulimi i kostove për blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve totale në Rrjetin e Shpërndarjes prej 24%;

- Pamundësinë e evidentimit të saktë të vlerave të aseteve sipas nivelit të tensionit;

- Ndarjen e aktiviteteve të shpërndarjes dhe furnizimit deri në fund të vitit 2018 kërkesë kjo e ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike";

- Gjykohet se nga eksperienca e deritanishme, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është në vështirësi financiare për mbulimin e kostove të tepërta të pambuluar në zbatim të VKM-së nr. 171, datë 25.2.2015. Për pasojë, aftësia likuiduese e kompanisë, me gjithë rezultatet pozitive financiare për periudhën 2015–2016, nuk ka përmirësuar marrëdhëniet midis operatorëve të tjerë të sistemit elektroenergjetik për shlyerjen e detyrimeve të ndërsjella.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 52, datë 6.4.2017, "Mbi lënien në fuqi të vendimit nr. 190 datë 22.12.2016, të Bordit të ERE-s" për tarifat e shërbimit të shpërndarjes si vijon:

- tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV: 1.5 lekë/kwh;
- tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 20 kV: 3.9 lekë/kwh;

- tarifa mesatare e shërbimit të shpërndarjes: 4.79 lekë/kwh;

2. Rishikimin e të ardhurave të kërkuara të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes në periudhat pasardhëse për vlerësimin e të ardhurave të kërkuara për vitin 2018.

3. Lënien në fuqi për vitin 2018, të pikave 3, 4 dhe 5 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 211, datë 28.12.2017, "Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të OSHEE sh.a., për tarifat e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike, sipas nivelit të tensionit dhe lënies në fuqi të çmimeve me pakicë për klientët që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal për vitin 2018".

4. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OSHEE sh.a., dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për vendimmarrjen e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti